




Financuar nga
Bashkimi Evropian

MINISTRIA E DREJTËSISË

Koordinatori Kombëtar Kundër
Korrupsionit



"Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Cowater International dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian








MINISTRIA E DREJTËSISË

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit

Që prej vitit 2017, Ministria e Drejtësisë ka marrë rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK). Në këtë rol, Ministria e Drejtësisë koordinon të gjitha përpjekjet strategjike dhe të politikave bazuar në një qasje tri dimensionale: parandalimin, ndëshkimin, dhe ndërgjegjësimin. KKK-ja administron inspektime dhe kontrole në sektorë të prirur për korrupsion dhe mbikëqyr veprimtarinë e Koordinatorëve të Rrjetit Antikorrupsion, të vendosur në 44 institucione qendrore dhe në nivel rajonal për zyrat vendore të 4 prej tyre.

Një kompetencë tjetër e KKK-së është të ndërgjegjësojë qytetarët mbi pasojat e korrupsionit, të informojë dhe të edukojë qytetarët në Shqipëri lidhur me çfarë mund të bëjnë ata për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Në përputhje me këtë kompetence, ky botim udhëzues ofron disa informacione thelbësore mbi korrupsionin dhe mënyrën e denoncimit të korrupsionit.



Ky informacion do t'ju ndihmojë për t'ju përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.

- Çfarë do të thotë termi “korrupsion”?
- Cili është ndryshimi midis “i pandershëm” dhe “i paligjshëm” në lidhje me korrupsionin?
- Si vepron korrupsioni kundër interesit publik?
- Cilat janë fushat kryesore ku hasen aktet korruptive?
- Cilat janë fushat ku korrupsioni shkakton më shumë dëm dhe cilat prej tyre janë më gjerësisht të përhapura?
- Ku dhe si mund ta denoncoj korrupsionin?
- Cili mekanizëm i denoncimit është më i mirë për fusha të ndryshme të korrupsionit?



ÇFARË KUPTOJMË ME “KORRUPSION” DHE KU E HASIM ATË

Që prej shumë kohësh korrupsioni njihet si një prej pengesave kryesore të zhvillimit. Ai gërryen shtetin e së drejtës dhe institucionet demokratike. Ai pengon zhvillimin ekonomik duke deformuar tregjet dhe dëmtuar integritetin e sektorit privat. Ai mund të shkatërrojë besimin e njerëzve në udhëheqjen politike të vendit dhe parimet themelore të qeverisjes demokratike.

Përkufizimi i korrupsionit – në kërkim të një përkufizimi

Përkufizimet e korrupsionit ndryshojnë në literatura të ndryshme.

- **Etimologjia** – nga fjala latine korrupsion - kalbëzim, vjetërsim, imoralitet ose pavërtetësi, rryshfetmarrje.
- **Përkufizimi universal:** “përdorimi i pozicionit publik për përfitime private”. Ky përkufizim përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si përvetësimin, pazaret vetjake dhe zbatimin selektiv të ligjit. Megjithatë, ai përqendrohet ekskluzivisht te sjellja e zyrtarëve qeveritarë, duke lënë jashtë korrupsionin në sektorin privat.
- **Përkufizimi i hasur në të Drejtën Ndërkombëtare:** Këshilli i Evropës, Konventa e së Drejtës Civile për Korrupsionin - “korrupsion” do të thotë kërkimi, ofrimi, dhënia ose pranimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i një rryshfeti ose i çfarëdolloj avantazhi të padrejtë, apo i pritshmërisë për to, i cili deformon kryerjen e rregullt të detyrave apo sjelljeve të duhura të marrësit të rryshfetit, avantazhit të padrejtë apo pritshmërisë për to.

• **Kryerja e korrupsionit kërkon elementët e mëposhtëm:**

- a) një zyrtar (ose një grup zyrtarësh) në sektorin publik (zyrtarë të administratës, politikanë, magjistratë, punonjës në fushën e ofrimit të shërbimeve, etj.);
- b) pushtet diskrecional (mundësinë për të marrë vendime autonome sipas gjykimit të vet);
- c) abuzim të pushtetit publik nga ana e zyrtarit;
- d) marrjen e përfitimeve vetjake ose në grup (financiare, materiale, ose favoreve) nga ana e zyrtarit/zyrtarëve.
- e) të tjera.

Kombinimi i ndryshëm i elementëve të lartpërmendura çon në lloje, forma, fusha, nivele dhe mekanizma të ndryshëm korrupsioni.



Llojet dhe format e korrupsionit

Klasifikimet e dhëna më poshtë tregojnë se veprat penale të korrupsionit ndodhin kur ka një përpjekje për të marrë përfitime të caktuara, ose për të shmangur shpenzime/sanksione të caktuara.

Ekzistojnë të paktën dy palë në një akt korrupsioni. Ato janë “dhënësi” dhe “marrësi”. Me fjalë të tjera, njëra palë (dhënësi) është personi që i ofron ryshfet tjetrit (korrupsioni aktiv), dhe pala tjetër (marrësi) është ai që e merr ryshfetin, ose që përfiton nga ryshfeti (korrupsioni pasiv). Të dyja palët kryejnë një krim. Të dyja palët duhet të përballen me burgim.

Nuk ka rëndësi nëse një menaxher i sektorit privat, një person që ushtron funksione publike, një zyrtar i lartë shtetëror, një zyrtar i zgjedhur, ose një anëtar i një institucioni të huaj merr një përfitim për veten e vet, ose për një person të tretë. Në të gjitha rastet, ata duhet të përballen me ndëshkime.

Korrupsioni institucional - aktivitete që diskreditojnë institucionin publik si një të tërë.

Korrupsioni individual - aktivitetet e ndërmarra nga një person i caktuar.

Korrupsioni i madh - aktivitete të padrejta të kryera nga zyrtarë të nivelit të lartë, të cilët janë në gjendje të marrin vendime dhe të ndajnë burime të konsiderueshme. Shumë shpesh korrupsioni “në shkallë të gjerë” shoqërohet me korrupsionin në nivelet e larta të pushtetit. Në këtë rast, krerët e shteteve, zyrtarët e lartë dhe politikanët përdorin pozicionin e tyre për të nxjerrë përfitime të mëdha personale, politike ose për korporatat. Ky lloj korrupsioni përfshin funksionimin e mekanizmave më kompleksë dhe më të

sofistikuar, ku ndërmjetësit luajnë rol kryesor. Meqenëse në këtë rast abuzimet dhe përfitimet e fituara, si dhe pasojat sociale dhe ekonomike janë të një shkalle shumë më të madhe, nuk ka asnjë kufi të qartë midis formës aktive dhe pasive të korrupsionit. Procesi zhvillohet me një transparencë minimale dhe drejtohet nga përfitimet e ndërsjella të kontraktuara.

Korrupsioni i vogël - aktivitete të padrejta të kryera nga zyrtarë të një niveli më të ulët, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarë, klientë dhe ndërmarrje. Në këtë rast, përfitimet (pagesa, dhurata, favore) janë më të pakta në vlerë, por janë të shtrira në një shkallë më të madhe dhe merren çdo ditë. Korrupsioni mund të kryhet në disa mënyra.

- Zyrtari deklaron drejtpërdrejt “çmimin” për aktivitetin ose favorin e kërkuar;
- Zyrtari nuk deklaron drejtpërdrejt se ai/ajo kërkon ryshfet, por vendos pengesa zyrtare dhe joformale, “nënkupton” se problemi mund të zgjidhet, duke e detyruar palën tjetër të sugjerojë një “alternativë korruptive”;
- Personi që ndërmjetëson për përfitimin e favorit deklaron dhënien e një “shpërblimi” korruptiv ndaj një zyrtari përkatës.

Korrupsioni për të përfituar një shërbim të ligjshëm - një zyrtar publik, detyra e të cilit është të kryejë një aktivitet të caktuar ose të ofrojë shërbime administrative, fiton në mënyrë të parregullt përfitime personale. Personi që ofron ryshfet shpesh e shikon këtë si një veprim “lehtësues” që siguron një zgjidhje më të mirë ose më të shpejtë të problemit

Korrupsioni për të përfituar një shërbim në mënyrë të paligjshme - zyrtari publik vepron duke siguruar përfitime personale në mënyrë të parregullt si edhe duke siguruar përfitime në mënyrë të paligjshme për personin që ofron ryshfetin.

Nepotizmi - shfaqja e favorizimit ndaj të afërmve dhe miqve, bazuar në marrëdhënien me ta, dhe jo në vlerësimin objektiv të aftësisë, meritokracisë ose përshtatshmërisë. Për shembull, ofrimi i punësimit për një të afërm, pavarësisht faktit se ka edhe të tjerë që janë më të kualifikuar dhe të gatshëm për të kryer punën, duhet të konsiderohet si nepotizëm.

Fushat e korrupsionit

Korrupsioni mund të haset praktikisht në të gjithë sektorët e jetës publike. Korrupsioni është fenomen kompleks dhe varet nga specifikat e historikut socio-kulturor të shoqërisë, zhvillimit politik dhe ekonomik të saj, traditave burokratike dhe praktikave qeverisëse.

Sjellja korruptive ka karakteristikat e veta në varësi të fushës specifike ku kryhet korrupsioni. Në përputhje me këtë, ne mund të bëjmë dallimin midis disa fushave themelore ku haset më shpesh shfaqja e korrupsionit:

- Korrupsioni në administratën publike (qeveria, institucionet publike, autoritetet vendore, etj.).
- Korrupsioni politik (Parlamenti, partitë politike).
- Korrupsioni në sistemin gjyqësor (gjykatat, prokuroria, organet ligjzbatuese).
- Korrupsioni në fushën e shërbimeve sociale (kujdesi shëndetësor, arsimi, shërbimi i mirëqenies sociale, etj.).
- Korrupsioni në sektorin privat (kompanitë që funksionojnë në nivel vendi, organizatat lokale të biznesit, media, etj.).
- Korrupsioni në sektorin terciar (shoqatat e shoqërisë civile, organizatat joqeveritare, etj.).

Korrupsioni haset më shpesh në sektorin publik. Institucionet dhe strukturat që përmbushin funksionet kryesore të shtetit janë ato të

cilat preken më shumë nga korrupsioni. Një ndër arsyt kryesore për shfaqjen e veprimeve korruptive në sektorin publik është përplasja midis interesave personale dhe publike të zyrtarëve. Për shkak të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe mundësisë për t'i përdorur ato, ata mund të përdorin mekanizma që çojnë në përdorim të paligjshëm të të drejtave dhe pushtetit për përfitime personale, ose në grup. Në rastet kur mekanizmat ligjorë në sektorin publik nuk janë efektivë, korrupsioni është alternativa e preferuar dhe ndonjëherë e vetmja alternativë për qytetarët. Çdo akt i suksesshëm i korrupsionit forcon dhe ushqen besimin se kjo është mënyra "normale" për të arritur qëllimet personale.

Ndër fushat më të shpeshta të veprimeve të korrupsionit në sektorin publik përmenden: sektori i shëndetësisë, sektori i arsimit, çështjet e pronës, doganat dhe tatimet. Sektorët ekonomikë të identifikuar nga përfaqësuesit e biznesit janë privatizimi, prokurimi publik, dhënia e licencave dhe lejeve për aktivitetet e biznesit, mbledhja e tatimeve, taksave doganore dhe tarifave, nepotizmi (emërimi i të afërmeve dhe miqve në pozitat drejtuese). Fusha të tjera ku korrupsioni është i përhapur janë pushteti gjyqësor dhe organet ligjzbatuese, korrupsioni në legjisllacion (kapja e shtetit), financimi i partive politike, etj.

Format penale të korrupsionit në legjislacionin shqiptar

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon forma të dënueshme korrupsioni dhe bën dallimin midis korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv si forma të korrupsionit, duke specifikuar veprimet e secilës palë:

Korrupsioni aktiv - premtimi, ofrimi ose dhënia, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e një avantazhi të padrejtë për një **zyrtar publik ose privat, vendas ose të huaj**, për vete ose për dikë tjetër, në mënyrë që ai **të kryejë ose të mos kryejë një veprim që lidhet me detyrën apo funksionin e tij, ose në shkelje të detyrës apo funksionit të tij.**

Korrupsioni pasiv - **Kërkimi ose marrja**, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga **zyrtari publik ose privat, vendas ose i huaj**, për vete ose për persona të tjerë, i çdo lloj përfitimi a avantazhi të parregullt apo i një oferte a premtimi të tillë, në mënyrë që ai **të kryejë ose të mos kryejë një veprim që lidhet me detyrën apo funksionin e tij, ose në shkelje të detyrës apo funksionit të tij.**

Kodi Penal parashikon sferën, dallimin e korrupsionit, kategoritë specifike të personave të akuzuar për kryerjen e veprimeve të tilla penale dhe sanksionet përkatëse.





KORRU



PSIONI

KORRUPSIONI AKTIV

NËSE NJË PERSON ...

... I JEP RYSHFET DIKUJT

... i premtos diçka

... një personi (për përfitim të tij/saj, ose për përfitim të një pale të tretë ...

... për të vepruar ose mosvepruar, në kundërshtim me detyrën e tij/ saj ...

... ofron diçka, ose i jep diçka

... një gjyqtari, prokurori, ose çdo punonjësi tjetër të institucioneve gjyqësore (për përfitim të tij/saj, ose për përfitim të një pale të tretë) ...

... për të kryer ose moskryer një veprim të lidhur me detyrën e tij/ saj ...

... i propozon diçka ...

... i propozon, ofron ose i jep diçka ...

... një dëshmitari, eksperti ose përkthyesi (për përfitim të tij/saj, ose për përfitim të një pale të tretë) ...

... për të siguruar deklarata ose dëshmi, ekspertizë ose detyra përkthimi/interpretimi të rreme, ose që çojnë në refuzimin e detyrimit të dikujt ndaj organeve të ndjekjes penale, ose gjykatës ...

... i premtos, propozon dhe jep diçka ...

... AI/AJO DUHET TË DËNOHET ME BURGIM	... NË VARËSI TË SEKTORIT	...SIPAS NENEVE TË KODIT PENAL
... nga tre muaj deri në tre vjet	Sektori privat	Neni 164/a
... nga gjashtë muaj deri në tre vjet	Sektori publik	Neni 244
... nga gjashtë muaj deri në tre vjet	Institucione të huaja publike	Neni 244/a
... nga një deri në pesë vjet	Zyrtarë të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendorë	Neni 245
... nga një deri në katër vjet	Sistemi i drejtësisë	Neni 319
... deri në katër vjet	Përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës	Neni 312

KORRUPSIONI PASIV

NËSE NJË PERSON QË ËSHTË ...

drejtues ose punonjës në sektorin privat

zyrtar publik

zyrtar i lartë shtetëror ose i zgjedhur vendor

gjyqtar, prokuror dhe funksionar tjetër i organeve të drejtësisë

... KËRKON OSE PRANON RYSHFET/ PËRFITIME NGA NJË RYSHFET ...

... për të vepruar ose mosvepruar në kundërshtim me detyrat e tij/saj ...

... kërkon, merr përfitime të parregullta, ose premtime për përfitime të padrejta ...

... pranon një ofertë ose premtim që rrjedh nga përfitime të parregullta ...

... për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij ...

**... AI/AJO DUHET
TË DËNOHET ME
BURGIM**

... nga gjashtë muaj deri
në pesë vjet

**... NË VARËSI TË
SEKTORIT**

Sektori privat

**... SIPAS
NENEVE TË
KODIT PENAL**

Neni 164/b

... nga dy deri në tetë
vjet

Sektori publik

Neni 259

... nga dy deri në tetë
vjet

Institucione të huaja
publike

Neni 259/a

... nga katër deri në
dymbëdhjetë vjet

Zyrtarë të lartë shtetërorë
ose të zgjedhur vendorë

Neni 260

... nga tre deri në
dhjetë vjet

Sistemi i
drejtësisë

Neni 319/ ç

ÇFARË MUND TË BËNI PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN?

Lufta kundër korrupsionit është një ndër sfidat më të mëdha për çdo vend të qeverisur nga shteti i së drejtës dhe parimet demokratike, përfshirë standardet e larta të integritetit dhe qeverisjen e mirë.

Kjo do të thotë që kërkon edhe mbështetjen tuaj.

Ky botim ofron udhëzime se si të denonconi rastet e korrupsionit. Nëse keni vënë re, ose dyshoni për një veprim korrupsioni, analizoni kutinë më poshtë. Tabela ju ndihmon të përcaktoni aktin e korrupsionit që keni parë dhe ju tregon se si ta trajtoni atë në përputhje me rrethanat. Më poshtë jepet një udhëzues se si të lexoni këtë tabelë: në të majtë duhet të zgjidhni vendin ku ka ndodhur korrupsioni (p.sh. në punë, në kontrolle doganore ose diku tjetër). Kolona tjetër tregon institucionin përgjegjës, d.m.th. organin ku mund të shkoni për të raportuar rastin. Kolona e tretë ofron detajet e kontaktit që do të nevojiten për të raportuar rastin tek autoritetet përkatëse.



SI TË DENONCONI KORRUPSIONIN?

FUSHAT E KORRUPSIONIT	INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI INSTITUCIONET QË PËRPUNOJNË DHE TRAJTOJNË DENONCIMET	DENONCO PËRMES:
<p>Çdo autoritet publik</p>	<p>Kontaktoni me njësinë përgjegjëse të institucionit tuaj</p> <p>Nëse institucioni juaj nuk ka një njësi për antikorrupsionin, kontaktoni me Ministrinë e Drejtësisë http://www.drejtesia.gov.al</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Blvd. Zog I, Tiranë</p> <p>e-mail: koordinatori.ak@drejtesia.gov.al</p>
<p>Nëse dyshoni ose jeni në dijeni të një praktike të veçantë korruptive, ju gjithashtu mund ta referoni çështjen te:</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Blvd. Zog I, Tiranë</p> <p>e-mail: koordinatori.ak@drejtesia.gov.al</p>
<p>Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion është zgjeruar në 44 institucione. Këto institucione janë:</p> <p>Në nivel qendror:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara; - Agjencia e Blerjeve të Përqendruara; - Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; - Agjencia Kombëtare e Bregdetit; - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; - Agjencia Kombëtare e Mjedisit; - Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; - Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë; 	<p>Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Blvd. Zog I, Tiranë</p> <p>e-mail: koordinatori.ak@drejtesia.gov.al</p>

SFERA E KORRUPSIONIT

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI INSTITUCIONET QË PËRPUNOJNË DHE TRAJTOJNË DENONCIMET

DENONCO PËRMES:

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
 - AlbControl sh.a.;
 - Albpetrol sh.a.;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
 - Autoriteti Portual Durrës;
 - Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 - Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
 - Instituti i Shëndetit Publik;
 - Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë;
 - Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
 - Porti Detar Sarandë sh.a.;
 - Porti Detar Shëngjin sh.a.;
 - Porti Detar Vlorë sh.a.;
 - Posta Shqiptare;
- Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza";

Rrjeti i
Koordinatorëve
Antikorrupsion

Ministria e Drejtësisë, Blvd.
Zog I, Tiranë

e-mail:

koordinatori.ak@drejtesia.gov.al

SFERA E KORRUPSIONIT

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI INSTITUCIONET QË PËRPUNOJNË DHE TRAJTOJNË DENONCIMET

DENONCO PËRMES:

- Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë";
- Spitali Universitar i Traumës;
- Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni";
- Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi";
- Spitali Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë;
- Spitali Psikiatrik "Sadik Dinci", Elbasan;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

Në nivel rajonal:

- a) në çdo drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- b) drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- c) drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- ç) spitalet rajonale.

Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion

Ministria e Drejtësisë, Blvd. Zog I, Tiranë

e-mail:

koordinatori.ak@drejtesia.gov.al

Nëse dyshoni ose jeni në dijeni të një praktike të veçantë korruptive nga administrata publike, ose zyrtarët publikë

Platforma e Bashkëqeverisjes

<https://shqiperiaqeduam.al>

Çdokush që dyshon, ose është në dijeni të një praktike korruptive, mund ta referojë çështjen tek:

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

- a) Zyra e Prokurorisë së Posaçme (ZPS)
- b) Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)

a) <https://spak.al/home/>
Zgjidhni dritaren: Raporto Raste Korrupsioni
b) www.bkh.al
Zgjidhni: dritaren Raporto Raste Korrupsioni

SINJALIZIMI DHE MBROJTJA E SINJALIZUESVE

Ligji 60/2016 "Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" parashikon se "çdo person që vihet në dijeni për sjellje apo praktika të dyshimta korrupsioni gjatë punës, ose në lidhje me veprimtarinë e tij gjatë punës në organizatë, ka të drejtë t'ia sinjalizojë këtë fakt njësisë përgjegjëse brenda organizatës së tij/saj ose ILDKPKI-së si një mekanizëm i jashtëm, sipas rastit." Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, me shkrim ose verbalisht tek ILDKPKI-ja, ose njësia përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej tyre.



Sinjalizuesit mbrohen në tre mënyra:

- e drejta e konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim
- ruajtja e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit
- mbrojtja kundër hakmarrjes.

Sinjalizuesit që bëjnë me dije ndonjë veprim ose praktikë të dyshuar korruptive në përputhje me dispozitat e këtij ligji, **mbrohen nga çdo akt hakmarrje** i ndërmarrë kundër tyre nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm te:

- largimi nga detyra;
- pezullimi nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- transferimi brenda ose jashtë organizatës;
- ulja në detyrë;
- ulja e pagës dhe/ose shpërblimit financiar;
- humbja e statusit dhe privilegjeve;
- mosngritja në detyrë;
- heqja e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- vlerësimi negativ i punës;
- forma të tjera hakmarrjeje në lidhje me detyrën e tij/saj.

Nëse jeni në dijeni të një rasti korruptiv, jeni të lutur të sinjalizoni/kontaktoni me ILDKPKI-në

<http://www.ildkpkj.al>

Numër pa pagesë:

08009999


e-mail: unedenoncoj@hidaa.gov.al




LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT PARANDALIMI – NDËSHKIMI – NDËRGJEGJËSIMI

MINISTRIA E DREJTËSISË
KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Gjeni më shumë informacion në adresat:
www.drejtesia.gov.al
<https://shqiperiaqeduam.al>





www.drejtësia.gov.al

